

KRITIKË E BIBLIOGRAFI

BARDHYL DEMIRAJ

REXHEP ISMAJLI «ARTIKUJ PËR GJUHËN SHQIPE»

Shtëpia Botuese «Rilindja», Prishtinë, 1987, 254 f.

Vargut të veprave shkencore të studiuesve kosovarë iu shtua kohët e fundit edhe libri i ri «Artikuj mbi gjuhën shqipe» i Rexhep Ismajlit. Ky libër përbledh një numër shkrimesh, të botuara nga autori në revista shkencore dhe periodikë me përhapje më të gjerë. Në to shtjellohen çështje të ndryshme nga problematika e larmishme që ngërthen hulumtimi i gjuhës shqipe dhe i historisë së saj, që dëshmon, në të njëjtën kohë, edhe gjerësinë e interesave shkencore të autorit.

Tematika e shkrimeve është e larmishme. Në to trajtohen probleme të historisë së përgjithshme të gjuhës shqipe (historia e brendshme dhe e jashtme e saj), ku përfshihen: *Prejardhja e gjuhës shqipe — probleme dhe rezultate* (f. 9-42); *Gjuha e trakasve* (f. 42-57); *Marrëdhëniet e shqipes me rumanishten* (f. 57-74); *Ndryshime fonetike të vona të shqipes dhe të rumanishtes*; (f. 74-88); *Huazimet latine të gjuhës shqipe* (f. 88-96); *Emri i shqiptarëve* (f. 96-105); *Fjalë shqipe në maqedonishte* (f. 163-175); probleme të onomastikës: *Çështje të onomastikës shqiptare* (f. 147-163); çështje të fonologjisë së sotme dhe historike të gjuhës shqipe: *Mbi disa çështje të zhvillimit fonetik të shqipes* (f. 175-184); *Edhe diçka rrëth rotacizmit në gjuhën shqipe* (f. 184-193); *Ndërlidhni kundërvëniesh të sistemit bashkëtingëllor të shqipes* (f. 201-212); *Fonemat marginale të sistemit bashkëtingëllor të shqipes* (f. 212-219); dhe filologji: *Grafia e Buzukut dhe disa çështje të sistemit fonetik të shqipes* (f. 105-147). Vëllimi myllitet me katër recensione të autorit mbi disa vepra shkencore në fushën e albanologjisë: *Gramatika strukturale e shqipes* (f. 212-219); *Gjuhët e Ballkanit antik sipas Katiçiçit* (f. 219-239); *Idriz Ajeti për historinë e gjuhës shqipe* (f. 239-246) dhe *Kontributi i B. Bokshit për ballkanistikën* (f. 246-254).

Shkrimet janë të ndryshme jo vetëm për nga tematika, por edhe nga mënyra e konceptimit dhe nga mesazhi që kumtojnë. Ndërsa në shkrimet e mirëfillta gjuhësore e filologjike materiali faktik u nënshtronhet analizave të shumanshme gjuhësore, historike e filologjike, të cilat, në mjaft raste kombinohen me sukses me njëra-tjetër, në shkrimin për onomastikën synohet kryesisht që në hulumtimin e materialit faktik të merren parasysh edhe kritere jashtëgjuhësore.

Ndryshe nga këto, në shkrimet për historinë e përgjithshme të gjuhës shqipe autori përpinqet t'i japë në mënyrë të sintetizuar lexuesit

të zakonshëm rezultatet e shkencës së albanologjisë për një numër çesh-tjesh të rëndësishme, si: prejardhja e gjuhës shqipe, vendi i saj në rrithin e gjuhëve i.e., vendi i formëzimit të saj si një gjuhë cilësishët e re, marrëdhëniet e saj me gjuhët fqinje etj.

Me një njojje të thelluar të mendimit gjuhësor albanologjik, Rexhep Ismajli rimerr në shqyrtim tezat kryesore të derisotme për problemet themelore të historisë së gjuhës shqipe, i shoshit ato dhe i pasuron me arritjet më të reja të gjuhësisë historike shqiptare, duke mbajtur, në të njëjtën kohë, qëndrim kritik ndaj atyre tezave, të cilave tashmë u ka kaluar koha.

Kështu, për autorin nuk mund të vihet më në dyshim që shqipja është një gjuhë e mirëfilltë i.e., e cila përfaqëson një grup të veçantë në familjen gjuhësore i.e. Ajo është një gjuhë i.e. e tipit *satem*, që vendoset në arealin qendror, meqenëse hyn në marrëdhënie të ndërsjella si me gjuhët veriore, sidomos me baltishten, slavishten dhe gjermanikishten, ashtu edhe me gjuhët i.e. jugore, kryesisht me latinishten, greqishten dhe armenishten. Në antikitetin pararomak shqipja ose më saktë «nëna» e saj është folur në Gadishullin Ballkanik. Argumente të mjaftueshme gjuhësore, historike dhe arkeologjike lejojnë të vendosen lidhje farefisnore të pandërmjetme të shqipes me njérën nga gjuhët paleoballkanike, e pikërisht me ilirishten, sikurse supozonin më parë J.G. Hahni, G. Majeri, H. Pederseni e më vonë N. Jokli, E. Çabej, R. Katiçiçi etj. Tezës mbi origjinën trake (dake, dako-mize, dako-gette etj.) të kësaj gjuhe i mungon tashmë edhe mbështetja gjuhësore, përvèç asaj historike dhe arkeologjike. Ithtarët e kësaj teze e kanë afruar shqipen me trakishten, duke u mbështetur në ndarjen *kentum* — *satem* të gjuhëve i.e. Sipas tyre, trakishtja, sikurse sot shqipja, ka qenë gjuhë *satem*, ndërsa ilirishtja ka qenë gjuhë *kentum*. Por studimet e sotme kanë treguar se për gjuhët e antikitetit ballkanik çështja e ndarjes në *kentum* dhe *satem* do shtruar ndryshe: palatalet i.e. jo në çdo pozicion janë zhvilluar në spirante. Në fqinjësi me sonanten ato u velarizuan. «Kjo tanihadh drithë të re mbi raportin shqipe-ilirishte, ilirishte-trakishte, trakishte-shqipe (f. 29v).

Vendosja e marrëdhënieve të drejtpërdrejta me ilirishten e saktëson vendin e formimit të gjuhës shqipe në Ilirinë e Jugut, duke përfshire edhe Dardaninë. Ky përfundim kushtëzon edhe shqyrtimin me objektivitet shkencor të marrëdhënieve të shqipes me rumanishten, pasi nëpërmjet tyre, janë ngritur dhe vazhdojnë të ngrihen pretendime që të shpjegojnë jo vetëm elementet e substratit (dak) të rumanishtes, por edhe vendin e formimit të gjuhës shqipe dhe origjinën e saj. Në një numër studimesh gjuhësore historike, ku dallohen veçanërisht ato të E. Çabejt, është vërtetuar tashmë që leksiku i përbashkët shqiptaro-rumun nuk është i të njëjtit burim, etimologjik dhe kronologjik. Gjithashtu, edhe paralelizmat fonetikë dhe gramatikorë s'janë të një burimi. Disa janë njëherësh paralelizma ballkanikë me origjinë mesjetare, disa janë paralelizma të krijuar thjesht nga tendenca e të dy gjuhëve drejt analitizmit, siç janë përfthuar edhe me gjuhë të tjera i.e. joballkanike. Ndërsa disa të tjera janë paralelizma të rastit. Prandaj teoria e substratit të përbashkët shqiptaro-rumun sipas autorit «mbetet gjallë, ashtu siç është artikulluar deri sot, ose për shkak të mungesës së shpjegimit gjuhësor

si kallauz i përgjithshëm që nuk shpjegon asgjë, ose si shprehje e paragjykimeve të ndryshme» (f. 91).

Vijimësia gjuhësore ilire-shqiptare siguron edhe vijimësinë historike sociale të emrave etnikë *arbër*, *arbëresh*, *Arbëri* (nga baza i.e. **arb-/alb-*) dhe *shqip* (lat. *excipio*, -ere); *shqipe*, *shqiptar*, *Shqipëri*. Kështu «ndërsa emërtimi *arbër*, *arbën* karakterizon periudhën e krijimit të pokullit në kohërat e largëta, emërtimi *shqiptar* imponohet natyrshëm në kohën e krijimit të kombit» (f. 99).

Në shkrimin për onomastikën merren në analizë *Krisobulat e Deçanit* (shek. XIV) dhë *Kronika e Tokos* (shek. XV). Duke ndërthurur këndvështrimin gjuhësor me atë historik social, autori vjen në përfundimin sllav, nuk mund të nxirren përfundime për përbërjen etnike të popullsisë, sepse emërtime janë të kushtëzuara nga mënyra e organizimit shogëror. Ato mund të merren vetëm si tregues për praninë e një etnikumi në një zonë të caktuar, ndërsa intensiteti i pranisë së tij duhet të nxirret nga analizat e tjera social-historike. Kështu, ndër toponimet antike të Ballkanit mbijetuan, sipas tij, emërtimet e pazbërthyeshme, si p.sh. *Naissus*; *Nish*; *Skupi*; *Shkupi*; *Astibos*; *Shtip*; *Ulcinum*: *Ulqin* etj. Ndërsa të tjerat, kuptimisht të zërthyeshme; u përkthyen dhe u adaptuan simbas gjuhës së etnikumit sundues sllav, si p.sh. *Mali i Zi*: *Montana Nera*; *Crna Gora*: *Karadak* etj.

Në shkrimet për fonologjinë e gjuhës shqipe trajtohen disa probleme të rrafshit sinkronik dhe diakronik. Në rrafshin sinkronik shqyrtohet, ndër të tjera, vlera fonologjike e kuantitetit të zanoreve të theksuar në dialektin geg, llojet e ndryshme të ndërlidhnive (korrelacioneve) dhe të kundërvënieve në sistemin bashkëtingëllor të gjuhës letrare shqipe, të cilat autori i paraqet edhe me terma të logjikës formale sipas modelit të Kantinoit (*raporti i përfshirjes*, *raporti i prerjes*, *raporti i identitetit*, *raporti i përjashtimit*); fonemat anësore /l/, /L/, /r/, /R/ të sistemit bashkëtingëllor e ndonjë tjetër.

Në rrafshin diakronik autori i kushton vëmendje të veçantë rolit që kanë luajtur geminatet në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit fono-grammatik të gjuhës shqipe. Kështu, sipas tij, fonema /L/ e ka zanafillën e saj te një variant geminant i fonemës /l/ në kufijtë e morfemave.

Me zhvillimin e geminateve, krahas çhundorëzimit të zanoreve hundore, autori lidh edhe përftimin e rotacizmit $/n/ \rightarrow /r/$ /V-V/ në dialektin tosk. Për përftimin e së ashtuquajturës /n/ të labërguar, e cila me kohë u rotacizua (H. Pedersen), autori mendon se «aty kemi të bëjmë më shumë me shtypje të geminateve, të cilat në shqipe s'janë ruajtur të tillë. Fonema /nn/ e kohës së interferencës shqiptare-latine dhe shqiptare-greke e vjetër anonte nga thjeshtëzimi, me g'rast kundërvënia gjithnjë duhej të ruhej. Konfliktet homonimike nuk ishin të rralla. Prandaj e ashtuquajtura /n/ e thjeshtë shqiptohej më e labërguar, për të mos u ngatërruar me /n/-në e fortë që vinte nga geminatet» (f. 189). Duke pohuar që hetimi i dukurisë së rotacizmit nga ky këndvështrim është më shumë interes, autori mund të motivonte më bindshëm përftimin e një foneme /nn/ dhe të përcaktonte vendin e saj në sistemin fonologjik të shqipes gjatë periudhës së ndikimit latin.

Interes të veçantë paragesin edhe mendimet e autorit për disa probleme të grafisë së Buzukut. Në zgjidhjen e çështjes *shkrim/sistem fo-*

netik te «Meshari», R. Ismajli përdor interpretimin fonologjik, duke bërë përqasje midis gjendjes që na paraqitet sot në përgjithësi në dialektin geg dhe te Buzuku. Ai shqyrton, ndër të tjera, rastet kur gjatësia nuk jepet me dyzim shkronjash, po me dy shkronja të ndryshme (*<ij>* = [i:]); merret me interpretimin e përdorimit të shkronjave *u*, *v*, *γ* dhe *i*, *j*, të cilat i kundron në kuadrin e raporteve *zanore e theksuar* ~ *zanore e pathekuar*, *zanore e shkurtër* ~ *zanore e gjatë*; *zanore e hapur* ~ *zanore e mbyllur*. Gjithashtu, ai studion problemin e vësh-tirë të interpretimit të shkronjës *h*, si edhe grafinë *<en->*, *<em->* të Buzukut, të cilat nuk dalin në shkrimet e mëvonshme të autorëve të Veriut.

Duke përfunduar këtë paraqitje të përbledhur të përbajtjes dhe të vlerave të veprës së R. Ismajlit «Artikuj mbi gjuhën shqipe» pohoj-më se kemi të bëjmë me një ndihmesë të mirë në fushën e studimeve të gjuhës shqipe dhe të historisë së saj. Në të rrihen çështje të rëndë-shme të gjuhësisë shqiptare, në të cilat autor i jo vetëm mbështet mendimet objektive e tashmë të argumentuara, por në mjaft raste sjell edhe ndihmesa e materiale të reja me vlerë.